



Universiteti Bujqësor i Tiranës

D-Com shpk

Nr. prot. 1465, Datë 08.05.2024

Nr. ____ Prot., Datë2024

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

dhe

D-Com shpk

Sot, më datë 05.04.2024 lidhet ky memorandum bashkëpunimi midis palëve:

1. **D-Com** me NIPT **M41315020B** me adresë Rruga Koder Vore, Tirane, Shqipëri, i përfaqësuar nga administratori Elidjan Shtëpënja,

dhe

2. **Universiteti Bujqësor i Tiranës**, me NIPT: **J61915028N**, me adresë Rruga Pajsi Vodica1025, Tirane, Shqipëri, përfaqësuar nga Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU në cilësinë e Rektorit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, këtej e në vazhdim cilësuar si **UBT**;

Të quajtura bashkarisht ose veçmas si

"Palët". Duke qenë se:

Palët kanë shprehur vullnetin për ngritjen e urave të bashkëpunimit midis tyre dhe bien dakort të nënshkruajnë këtë memorandum bashkëpunimi me kushte si më poshtë vijon:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandumi është bashkëpunimi midis Palëve për realizimin e veprimtarive me interes të ndërsjelltë duke formalizuar bashkëpunimin sipas pikave të poshtë përmendura në Nenin 2.

Neni 2

Angazhimet e palëve

1. Palët marrin përsipër të bashkëpunojnë bazuar në frymën e një mirëkuptimi reciprok dhe vullneti pozitiv për të siguruar kushtet e nevojshme për realizimin e angazhimit dhe iniciativave të ndërmarra nga palët.
2. Kompania D-Com shpk merr përsipër të sigurojë paketën profesionale promovuese (foto dhe video profesionale) për UBT .
3. Kompania D-Com shpk shpreh gatishmërinë të ofrojë suportin e saj me anë të mjeteve promovionale, sipas nevojës që UBT do të ketë në aktivitetet që organizon.
4. D-Com ofron mundësinë e praktikave profesionale dhe trajnimeve për studentët e UBT-së.
5. D-Com ofron mundësi punësimi për studentët e UBT-së, part time dhe full time.
6. UBT merr përsipër të ofrojë mbështetje si më poshtë:
 - Vënia në dispozicion të hapësirave të Universitetit në funksion të D-Com shpk për të kryer aktivitetet e tyre promovionale sipas fushatave që ata kanë.
 - Mundësinë e shpërndarjes së thirrjes për vende vakante në faqen e saj të web-it ose në rrjetet e saj sociale.
 - Bashkëpunimi për hapjen e thirrjeve të vendeve vakante në kompaninë D-Com shpk.

Neni 3

Personi kontaktit

1. Personat e kontaktit do të jenë përgjegjës për zbatimin e këtij memorandumi, me qëllim realizimin e objektivave duke komunikuar dhe shkëmbyer të dhënat në mënyrë sa më korrekte dhe efektive.
2. Personat e kontaktit për secilën palë, në kuadër të implementimit të këtij memorandumi

janë: Për D-Com shpk : **Elidjan Shtëpënia**

Për UBT: **Prof.asoc.Dr. Romina Koto**

3. Në rast të ndryshimit të njërit prej personave të kontaktit ,pala e cila përfaqësohet prej këtij

personi duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda një jave kalendarike për të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 4 Afati

1. Ky memorandum bashkepunimi lidhet për një afat **2 vjeçar**.
2. Afati fillon nga data e nënshkrimit të tij nga të dy palët.
3. Çdo njëra nga palët mund të kërkojë të zgjidhë memorandumun duke lajmëruar palën tjetër me shkrim të paktën një muaj përpara datës së zgjidhjes.

Neni 5 Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim apo keq interpretim në realizimin e këtij memorandumi do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve, në frymën e bashkëpunimit, tolerancës dhe kuadrit të etikës morale.

Neni 6 Dispozita kalimtare

1. Palët janë të detyruara të respektojnë këtë memorandum bashkëpunimi për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në Nenin 4.
2. Memorandumi mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.
3. Kushtet e këtij Memorandumi Bashkëpunimi pranohen dhe nënshkruhen nga të dyja palët.

Neni 7 Konfidencialiteti

Të dy palët bien dakort të respektojnë kushtet e konfidencialitetit.
Ky memorandum do të hartohet në 3(tre) kopje me vlere të njëjtë, nga të cilat 1(një)mbahet nga D-Com shpk dhe 2 (dy) mbahen nga UBT.

PALËT NËNSHKRUESE

Firmosur në U.B.T. më datë/ 08 / 05 /2024, në tre kopje origjinale.

UNIVERSITETI BUJQËSORI TIRANËS

D-COM SHPK

Prof.Dr. Fatbardh SALLAKU

Z. Elidjan Shtëpënja

